Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

RREGULLORE (QRK) NR. 09/2026 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES (QRK) NR.08/2021 PËR EMERGJENCAT DHE MONITORIMIN RADIOLOGJIK

1. Rregullore (QRK) Nr. 09/2026 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) nr.08/2021 për Emergjencat dhe Monitorimin Radiologjik, është miratuar në mbledhjen e 11-të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 14/11 të dt. 16.11.2026

Qeveria e Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 25 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-029 për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore (Gazeta Zyrtare Nr. 5, datë 27.04.2018), nenit 19 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-123 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që kanë të bëjnë me Racionalizimin dhe Vendosjen e Vijave Llogaridhënëse të Agjencive Ekzekutive (Gazeta Zyrtare Nr. 11, datë 17.05.2023), nenit 8 paragrafi 4, nën-paragrafi 4.5 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe nenit 78 paragrafi 6 nën-paragrafi 6.2 të Rregullores Nr. 17/2024 së Punës së Qeverisë,

Miraton:

RREGULLORE (QRK) NR. 09/2026 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES (QRK) NR.08/2021 PËR EMERGJENCAT DHE MONITORIMIN RADIOLOGJIK

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores (QRK) Nr.08/2021 për Emergjencat dhe Monitorimin Radiologjik.

Neni 2

Në tërë tekstin e Rregullores bazë, emërtesa "Agjencia" zëvendësohet me emërtesën "Ministria".

Neni 3

1. Neni 3, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4, i Rregullores bazë, plotësohet dhe ndryshohet, me tekstin si në vijim:

1.4. **Dozë Indikative (DI)** – dozë efektive e pritshme që krijohet nga gëlltitja gjatë një (1) viti e të gjitha radiobërthamave, prania e të cilave është zbuluar në furnizimin me ujë që përdoret për konsum njerëzor, me origjinë natyrore dhe artificiale, por duke përjashtuar tritiumin, kaliumin-40, radonin dhe produktet e tij jetëshkurtra të zbërthimit;

Neni 4

1. Neni 10, paragrafi 1, i Rregullores bazë, plotësohet dhe ndryshohet, me tekstin si në vijim:

1. Ministria do të bashkëpunojë me shtetet anëtare të BE-së, shtetet e rajonit dhe me vendet e treta në trajtimin e emergjencave të mundshme në territorin e saj e të cilat mund të ndikojnë në këto shtete, për të lehtësuar organizimin e mbrojtjes radiologjike bazuar në sistemet dhe protokollet ndërkombëtare të shkëmbimit të informacionit.

Neni 5

1. Neni 11, paragrafi 1, i Rregullores bazë, plotësohet dhe ndryshohet, me tekstin si në vijim:

1.Ministria siguron që janë marrë masa, sipas treguesve ose evidencës së ekspozimeve që nuk përfillen nga pikëpamja e mbrojtjes nga rrezatimi, për të identifikuar dhe vlerësuar situatat e ekspozimit ekzistues duke marrë parasysh llojet e situatave të ekspozimit ekzistues të përcaktuara në Rregulloren përkatëse për Burimet e Rrezatimit dhe Praktikat.

Neni 6

1. Neni 16, paragrafi 1, i Rregullores bazë, plotësohet dhe ndryshohet, me tekstin si në vijim:

1. Ministria, përmes shërbimit teknik profesional të licencuar, të përgatitur sipas udhëzimeve të përcaktuara në Rregulloren bazë, siguron zbatimin e masave për kontrollin, rigjenerimin dhe depozitimin e burimeve jetime, si dhe hartimin e planeve të reagimit dhe masave të duhura për menaxhimin e tyre.

Neni 7

1. Neni 21, paragrafi 1 dhe 3, i Rregullores bazë, plotësohen dhe ndryshohen, me tekstin si në vijim:

1. Ministria harton një plan kombëtar veprimi që përshkruan rreziqet afatgjata nga ekspozimet e radonit në ndërtesa, ndërtesa me qasje publike dhe në vendet e punës për çdo burim të hyrjes së radonit, qoftë nga toka, materialet e ndërtimit ose uji. Plani i veprimit merr parasysh çështjet e përcaktuara në Rregulloren përkatëse për Burimet e Rrezatimit dhe Praktikat, dhe duhet të përditësohet rregullisht.

3. Pas krijimit të hartave të rrezikut për radon Ministria identifikon zonat ku përqendrimi i radonit si mesatare vjetore në një numër të konsiderueshëm ndërtesash tejkalon nivelin kombëtar përkatës të referencës.

Neni 8

1. Neni 22, paragrafi 1 dhe 2, i Rregullores bazë, plotësohen dhe ndryshohen, me tekstin si në vijim:

1. Niveli i referencës që zbatohet për ekspozimin e jashtëm nga rrezatimi gama, i emetuar nga materialet e ndërtimit brenda mjediseve të mbyllura, përveç ekspozimit të jashtëm në këto mjedise, nuk duhet të tejkalojë një (1)mSv/vit.

2. Për materialet e ndërtimit të cilat janë identifikuar si shqetësuese prej Ministrisë nga pikëpamja e mbrojtjes prej rrezatimit, duke marrë parasysh listën treguese të materialeve të përcaktuara në Rregulloren përkatëse për Burimet e Rrezatimit dhe Praktikat, Ministria përpara se këto materiale të tregtohen siguron që:

2.1. janë përcaktuar përqendrimet e aktivitetit të radiobërthamave të përcaktuara në Rregulloren përkatëse për Burimet dhe Praktikat e Rrezatimit;

2.2. është siguruar informacioni për inspektoratin e ndërtimit të komunës përkatëse, në qoftë se kërkohet, për rezultatet e matjeve dhe të indeksit përkatës të përqendrimit të aktivitetit, si dhe për faktorë të tjerë përkatës, siç përcaktohet në Rregulloren përkatëse

për Burimet e Rrezatimit dhe Praktikat.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin Kurti

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Datë:17.nëntor. 2026